


# PREPORTR


## ISA N'FRON!

Komuna e Prishtinës funksionon si oborr privat i LDK-së.  
Visar Duriqi dhe Qëndrim Bunjaku (2-5)

## QYTETI PA ZOT.

Kur mbaroi lufta, në kryeqytetin e Kosovës, u çlirua bisha e ndërtimeve të egra, që e shndërruan atë në një qytet me arkitekturë turbo-folk. Besnik Boletini, Besa Kalaja (6-8)





Komuna e Prishtinës funksionon si oborr privat i LDK-së. Hulumtimi i Preportr, është bllokua totalisht nga ana e punonjësve të Komunës së Prishtinës, duke mos ofruar as informacione që do të duhej të ishin publike. Megjithatë, Preportr, ka arritur të hulumtojë shpërndarjen e afro 100 milionë eurove në tenderë publike nga viti 2007-2012. Hulumtimi nxjerr në pah se afro 35 % e kësaj shume u është ndarë kompanive që kanë pasur borxhe ndaj komunës, e kanë mashtruar atë, i kanë shkelur kontratat me të ose kanë vazhduar të marrin tenderët përkundër faktit që për to u nisën hetime për korrupsion në komunë. Në komunën e krye-opozitarit Mustafa, mbi 13 milionë euro i përfituan financuesit e PDK-së dhe kompanitë e ndërlidhura me këtë parti. Hulumtimi tregon që Komuna e Prishtinës, nuk është aspak immune ndaj keq-përdorimeve me paranë publike dhe favorizon kompani të caktuara që kanë lidhje me kreun e saj. Në këtë hulumtim shihet se kompani ose konzorciume që kanë pasur pronarë të njëjtë kanë konkurruar nëpër tenderë dhe i kanë fituar ato. Madje në rastin e licencës për radio taksin “City Taxi”, kreu i komunës del të jetë shumë ngushtë i lidhur me këtë licencë. Derisa Komuna që tradicionalisht udhëhiqet nga LDK-ja vazhdon të jetë e mbyllur, nën akuzën për korrupsion pritet të gjykohej kryesuesi i kuvendit, Sami Hamiti, dhe shefi i deritanishëm i prokurimit, Ekrem Rexha. Në Komunën e Prishtinës hisja e ortakëve të djemve të Fatmir Sejdiut në fondet publike vazhdon e paprekur.

# ISA N'FRONI!

VISAR DURIQI DHE QËNDRIM BUNJAKU

Është ish-funksionar i lartë i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, por që nga nëntori i 2010-së, drejton partinë më të madhe opozitare, Lidhjen Demokratike të Kosovës, (LDK), ndërsa kryeqytetin kosovar, Prishtinën, që nga viti 2007.

Isa Mustafa kishte bërë famë kryesisht duke kritikuar liderin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hashim Thaçin, por në komunën që ai drejton, keqpërdorimi me paranë dhe asetet publike është shndërruar në normë.

Preportr ka shikuar mbi 280 tenderë me vlerë të madhe dhe të mesme që nga fundi i vitit 2007 deri në fundin e vitit 2012, vlera e të cilëve është afro 100 milionë euro, dhe të cilat u janë ndarë afro 270 kompanive.

Komuna e Prishtinës ka penguar në vazhdimësi realizimin e këtij hulumtimi duke refuzuar për t'u përgjigjur kërkesave për informata, të cilat do duhej të ishin në pronësi të publikut.

Nga ky hulumtim, Preportr nxjerr se afro 35 % e tenderëve, nga vlera totale prej afro 100 milionë eurosh që janë hulumtuar, Komuna e Prishtinës i ka ndarë për kompani që kanë pasur borxhe ndaj komunës, e kanë mashtruar atë, i kanë shkelur kontratat me të, ose ka vazhduar për t'u dhënë tenderë kompanive për të cilat u nisën hetime për korrupsion në këtë komunë. Këtu bëjnë pjesë kryesisht tenderët që iu dhanë biznesmenit Ragip Mustafa, kompanive të familjes Zymberi, kryesisht tenderët e fituar me kompaninë “All Zone” dhe kompanitë e tjera të

kësaj familje të ndërlidhura me mashtrimin e komunës kur iu shit kamioni i zjarrfikësve për afro 30 herë më shtrenjtë se çmimi i tregut, tenderët e kompanisë “Çlirimi” nga Prizreni si dhe kompanisë “ABC” nga Podujeva.

Lista e kompanive që përfitojnë nga buxheti komunal, që asnjëherë nuk është nën 57 milionë euro për vit, është e mbushur me kompani financuese të PDK-së. Kështu, nga shuma e nxjerr nga Preportr, del se financuesit e PDK-së nga kjo vlerë prej 100 milionë, kanë marrë mbi 8 milionë euro, kurse kompani të cilat në një formë apo tjetër janë të lidhura me PDK-në, kanë marrë mbi 5.7 milionë euro.

Nga të gjitha hulumtimet e derisotshme të Preportr, ky për Komunën e Prishtinës, ka marrë më

së shumti kohë dhe ka qenë më i vështiri. Komuna e Prishtinës është e mbyllur, gati-gati e kthyer në një aset personal të atyre që janë në krye të saj. Përpos që nuk është lejuar qasje në asnjë dokument të kërkuar, as kryetari Isa Mustafa nuk ka pranuar që të intervistohet. Kjo mbyllje, sido që të jetë, nuk ka arritur të fshih keqpërdorimet në administratën e kryeqytetit.

Derisa Mustafa, lideri i partisë më të madhe opozitare në vend, nuk pranon të flasë, dokumentet flasin për një dekadë keqpërdorimesh me buxhetin publik në Komunën e Prishtinës, të udhëhequr pa ndërprerë nga LDK-ja, që nga zgjedhjet e para komunale të vitit 2000.

Me tenderët, në pjesën më të madhe të kësaj kohe udhëhoqi Ekrem Rexha, tash me aktakuzë


të konfirmuar për shpërdorim të detyrës zyrtare në bashkëpunim edhe me pesë kolegë nga kjo komunë. Përkundër akuzave, ai është avancuar në pozitën menaxher i projekteve ekonomike.

Në përgjithësi, Preportr ka gjetur se në këta tenderë prijnë kompanitë që në një formë kanë kontraste me komunën si dhe kompanitë e ndërlidhura me PDK-në. Por edhe LDK-ja ka përfituar nëpërmjet aseteve tjera publike, sikur të licencat e taksive, favorizimi i kompanive që kanë financuar fushatat elektorale të saj etj.

## ZONA E MUZGUT

Që nga viti 2007, tenderët e dhënë nga Komuna e Prishtinës, pareshtur favorizuan kompani të cilat ose janë të lidhura politikisht me ndonjërin nga partitë e

# 36 MILIONË EURO PËR KOMPANITË E PAPËRGJEGJSHME



**Preportr ka gjetur se afro 35% e tenderëve, të vlerës totale prej afro 100 milionë eurosh që janë hulumtuar, Komuna e Prishtinës i ka ndarë për kompani që kanë pasur borxhe ndaj saj, e kanë mashtruar atë i kanë shkelur kontratat me të ose edhe kanë vazhduar të marrin tenderët me gjithë faktin që kundër tyre u nisën hetime për korrupsion**

mëdha në pushtet, ose janë kompani që tanimë veç kanë dështuar në kryerjen e shërbimeve me tenderët e kaluar.

Kompania "All Zone", por edhe kompanitë e biznesmenit Ragip Mustafa kanë këto karakteristika dhe kanë marrë shuma të mëdha parash nga ky institucion. Kjo i bënë kompanitë e Mustafës si të jenë kompani të vetë komunës. Madje, baba i Valon Zymberit, pronarit të "All Zone", Ragip Zymberi, punon në Komunën e Prishtinës, kurse Ragip Mustafa është i shpërblyeri i kësaj komune prej tenderëve për furnizim me xhama e deri te tenderi më i fundit për rreth-rrotullimin në Veternik, rreth të cilit pati shumë ankesa.

"Beni Dona Plast" dhe "Olti Trasing", kompani të Ragip Mustafës, janë kontraktorë të rregullt të Komunës së Prishtinës. Preportr, ka gjetur se Mustafa me këto dy kompani ka marrë tenderë dhe hise në tenderë, si pjesë e konzorciumeve, shuma që kapin vlerën prej 3.4 milionë eurove. Kompania "Beni Dona Plast", sipas gjetjeve të Auditorit (ZAP), ka qenë një kohë të gjatë e papërgjegjshme ndaj Komunës së Prishtinës, por megjithatë del që ajo është favorizuar duke iu vazhduar kontrata kundërligjshëm.

Kjo kompani bën edhe ndërtime kolektive pa leje. Ragip Mustafa, në lagjen Ulpiana, rruge "Imzot Nikë Prela", ka ndërtime objekt kolektiv pa leje ndërtime. Ajo ndërtesë është shumë e dukshme, dhe mban mbishkrimin "Beni Dona". Ky biznesmen, "rrugëtimin e favorizimit" nga Ko-

muna e Prishtinës e kishte nisur që në vitin 2005, kur ishte kryetar Ismet Beqiri, tash kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së në Parlamentin e Kosovës.

ZAP në vitin 2006 gjeti se për parkingjet publike nëpër trotuare, Komuna e Prishtinës kishte kontraktuar kompanitë "Beni Dona Plast", dhe "LTG". Këto dy kompani i mbetën borxh komunës në vlerë prej 164,480 eurosh. "Nga viti 2005, Komuna ka pasur kontratë me ndërmarjen "Beni Dona" për dhënie në shfrytëzim të vendeve për parkim publik në rrugët e qytetit. Kjo kontratë është vazhduar edhe njëherë deri me 30.06.2006. Nga zyrtarët përgjegjës në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, është thënë se kontrata është vazhduar edhe për vitin 2007. Mirëpo, kjo nuk është ofruar si dëshmi ekipit të auditimit", shkruajnë auditorët.

Nga raportimet e auditorit del se sa më i papërgjegjshëm që tregohej biznesmeni Mustafa, ndaj Komunës së Prishtinës, aq më zemërgjerë tregohej komuna ndaj tij. Pagesën prej 7,020 eurosh për muaj që duhej t'ia paguante kompania "Beni Dona Plast" e Mustafës për shfrytëzimin e hapësirës publike për biznes, Komuna ia kishte zvogëluar, derisa borxhet kishin arritur dhjetëra-mijëra euro. Auditorët po ashtu gjetën se kompania "Beni Dona Plast", më 2007 e 2008 ka menaxhuar me parkingjet publike pa vazhdim të kontratës dhe borxhi i saj ndaj komunës vlerësohet mbi 50 mijë euro.

Ragip Mustafën e gjejmë

## Vlera totale që këto kompani ka marrë nga Komuna e Prishtinës është mbi 36 milionë euro.

KOMPANITË QË I SHKELËN KONTRATAT, SIPAS DREJTORISË SË INFRASTRUKTURËS TË KOMUNËS SË PRISHTINËS DHE U SHPËRBLIEN:

**"Toifor"**  
NË VITIN 2011-2012 KA MARRË TENDERË NË VLERË PREJ MBI **670 MIJË EURO**. DERISA QË NGA VITI 2006 JANË HISEDARË TË FONDEVE PËR MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE.

**"Noti"**  
KOMPANI NGA PRISHTINA NË VITIN 2009-2010 KA MARRË TENDERË NË VLERË MBI **1.4 MILIONË EURO**.

**"ABC"**  
KOMPANI NGA PODUJEVA GJATË TRI VITEVE 2010-2012, KA MARRË TENDERË DHE HISE NË TENDERË, VLERA E TË CILËVE MBËRRIN NË MBI **6.2 MILIONË EURO**.

**"Ekskavatori"**  
NGA VITI 2009-2012 KA MARRË TENDERË NË VLERË PREJ **3.2 MILIONË EURO**.

**"Unicom"**  
KA MARRË TENDERË DHE HISE NË TENDERË, PARA QË KAPIN VLERËN MBI **4.6 MILIONË EURO**.

**"Euro Garten"**  
GJATË VITEVE 2009-2012, KA MARRË TENDERË NË VLERË **930 MIJË EURO**.

**"Gashi Ing"**  
NË VITIN 2012 KA MARRË TRE TENDERË QË SË BASHKU PËSHOJNË AFRO **480 MIJË EURO**.

përsëri te tenderët, edhe në vitin 2012. Këtë vit ishte raportuar që tenderi prej 2.1 milionë eurosh për "Ndërtimi i rrethrotullimit në dalje të Prishtinës -drejtimi i Veternikut, pjesa e parë" i ishte dhënë këtij biznesmeni, edhe pse kompania "Olti Trasing", sipas dy kompanive ankuese në OSHP, nuk i kishte kryer disa punë të kontraktuara më herët me Komunën e Prishtinës, me gjithë se kjo sanksionohet në kriteret e tenderit. Me këtë pretendim u nisën edhe kompania "Alko Impex" dhe "R&Rrukolli" që të ankoheshin në OSHP, por e humbën rastin.

Një situatë e ngjashme është edhe me bizneset e familjes Zymberi, veçse ato filluan tek në vitin 2009 me tenderët publik në Komunë., Fillimi dukej të ishte i "mbarë", pasi që familja Zymberi me kompaninë "All Zone", i shiti Komunës së Prishtinës një kamion për zjarrfikës për "27 herë më shtrenjtë sesa ishte deklaruar në Doganat e Kosovës", bazuar në të dhënat e ZAP-it, duke mashtruar kështu këtë institucion.

Kështu, "All Zone", pronë e Bekim, Valon, Besnik Zymberit nga Komuna e Prishtinës, që nga viti 2009 e deri në vitin 2012, ka marrë tenderë si e vetme si dhe duke qenë pjesë e konzorciumeve, vlera që kapin shifrën mbi 11.7 milionë euro. Komuna e Prishtinës, vitin që shkoi, ia besoi kësaj kompanie, në konzorcium me kompaninë "ABC" nga Podujeva, ndërtime dhe sheshit "Ibrahim Rugova", derisa në garë ishte edhe kompania me famë ndërkombëtare në fushën e ndër-

timtarisë, "Mabetex", e krijuar nga zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, lideri i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli. Pas nisjes së punëve në shesh, "ABC" u tërhoq nga tenderi.

Preportr në hulumtimin "KEK-Korporata e Korrupsionit" gjeti se kompania "Pro Trade" e Suzana Zymberit, që ishte po ashtu njëra nga kompanitë konkurruese në tenderin e kamionit të zjarrfikësve, që doli të jetë i kurdisur, ka marrë tenderë publik në KEK. "Pro Trade", kompani në pronësi të Suzana Zymberit për person kontaktues ka Valon Zymberin, pronarin e kompanisë përfutuese të tenderëve në Komunën e Prishtinës, "All Zone". "Pro Trade" e Suzana Zymberit, nga viti 2008-2011, ka marrë nga Komuna e Prishtinës tenderë në vlerë prej 883 mijë eurosh.

Në vitin 2010, "Pro Trade" në lagjen më të frekuentuar "Pejton", ka marrë me koncesion nënkalimin. Nga ndërtimi me koncesion i nënkalimit dhe dhënia me qira e tij, komuna fiton qira mujore prej 160 eurosh. Edhe pse në ndërtim e sipër, zyrtarët komunalë kishin thënë se ai do t'i ketë 7 lokale dhe disa banjo publike, më pas nuk doli kështu. Nënkalimi sot ka 10 lokale, duke përfshirë këtu edhe lokalit "URBANO & FOOD COFFEE" që është pronë e Besnik Zymberit, po ashtu një nga personat e "All Zone". Ndërkohë që ky lokal ka zaptuar një pjesë të mirë të pronës publike me vendosjen e karrigeve jashtë lokalit, ani pse zyrtarët komunalë thonë se i ka me leje.

Ka shumë kompani që vazhdojnë të shpërblehen me tenderë nga komuna edhe pse ato kanë bërë shkelje të kontratave me po këtë autoritet. Kompania "ABC" nga Podujeva, pronë e Arben Jetullahut, nga hulumtimi i Preportr, del se ka marrë tenderë dhe hise nga disa të tjerë, duke hyrë në konzorciume, vlera e të cilëve mbërrin mbi 6.2 milionë euro në vitet 2011-2012. Kjo kompani ka vazhduar të shpërblehet me tenderë edhe pse në vitin 2009, nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale në Komunën e Prishtinës, ishte futur në listën e kompanive që patën shkelur kontratat publike.

"Ekskavatori", pronë e Isa, Bajram, Ibush e Haziz Ryshajt nga Ferizaj, nga viti 2009-2012 ka marrë tenderë në vlerë prej 3.2 milionë eurosh, nga Komuna e Prishtinës. Kjo kompani në vitin 2008, kur MASHT-in dhe ish-MTPT-në po i udhëhiqnin Enver Hoxhaj, respektivisht, Fatmir Limaj, të dy nënkryetarë të PDK-së, ka marrë tenderë, dhe hise nëpër tenderë, duke qenë pjesë e konzorciumeve, të cilët kapin vlerën mbi 11.7 milionë euro. "Ekskavatori", nga Drejtorati i Infrastrukturës Lokale, ishte futur në mesin e 9 kompanive që i kishin shkelur kontratat me komunën në vitin 2009, por ka vazhduar të shpërblehet nga Komuna e Prishtinës.

Kompanitë që nuk kanë përbushur kontratat e mëhershme e që kanë marrë sërish tenderë gjatë këtij viti janë: "Toifor" nga Prishtina, "ABC" nga Podujeva, "Park projekt", "Euro-Garden" nga Lipjani etj. Arsyeja e komunës është se atyre "u intereson veç çmimi".

### BIZNESET E PDK-SË NË KOMUNËN E LDK-SË

Preportr në hulumtimin "100 milionë" gjeti se mbi 100 milionë euro janë shpërndarë nga partia e kryeministrit Hashim Thaçi për kompanitë që atij ia zgjatën dorën gjatë fushatave zgjedhore. Nga dokumentet zyrtare, ky hulumtim ka gjetur se 43 subjekte të ndryshme, që financuan PDK-në, sistematikisht u shpërblyen nga institucionet që drejtojnë njerëzit e kësaj partie, madje duke mos u kursyer as nga shkeljet e ligjit.

Shpërblyeri për kompanitë financues të PDK-së dhe kompanitë e ndërlidhura me këtë parti nuk ka munguar as në komunën e kryeopozitarit, Isa Mustafa.

"Bageri", pronë e Bujar Shabanit nga Ferizaj, në vitin 2012 është shpërblyer me tenderin "Asfaltimi i rrugëve ne Shkabaj dhe Rimanishtë", me shumën 124 mijë euro, nga Komunën e Prishtinës. Pronari i saj, në vitin 2009 kishte dhënë 1 mijë euro donacion për PDK-në dhe është kontraktor i disa institucioneve që udhëheq kjo parti, ku vlera që ka marrë nga to është mbi 1.2 milionë euro. Kjo kompani, sipas profilit të saj në internet, si pjesë të saj ka edhe bazën e prodhimit të asfaltit në Komunën e Lipjanit, emri i së cilës është "Kosova Asfalt". Kjo e fundit, në një publikim të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor është futur në listën e kompanive të cilat me veprimtarinë e tyre e dëmtojnë ambientin. Në këtë publikim, "Kosova Asfalt" e kompanisë "Bageri" thuhet se ndotë ujërat nëntokësore.

"Bejta Commerce", pronë e Bashi dhe Adem Kçikut nga Gjilani, në vitin 2012 është shpërblyer nga Komuna e LDK-së me tre tenderë që peshojnë bashkë mbi 880 mijë euro. "Bejta Comerc", në dy fushatat zgjedhore, atë të vitit 2009 dhe vitit 2010, dha për PDK-në, 1499 euro, ku vetëm nga ish-MTPT-ja, ka fituar kontrata në vlerë prej 7.5 milionë eurosh.

"Beni - Com", pronë e Ismet Konushevcit, që nga viti 2010-2012, në Komunën e Prishtinës ka marrë tenderë, dhe hise nëpër tenderë si pjesë e konzorciumeve të cilët kapin vlerën mbi 3 milionë euro. "Beni Com" nga Podujeva, që në dy fushatat e fundit zgjedhore dha për PDK-në 3900 euro, ka marrë nga ish-MTPT-ja, 9.4 milionë euro, derisa vlera e tenderëve që ka marrë nga institucionet që drejtojnë njerëzit e partisë së Thaçit, kalon mbi 11 milionë euro.

Në vitet 2011-2012, "Kastrioti", pronë e Kastriot Fazlajit nga Shtimja, në Komunën e Prishtinës

► VAZHDON NGA FAQJA 3

ka marrë hise nga katër tenderë, duke qenë pjesë e konzorciumeve, vlera e të cilëve peshon mbi 3.6 milionë euro. Këta tenderë i ka marrë në konzorcium, veç e veç me “Led- di Ing” nga Shtimja dhe “Arhiko”.

Kastriot Fazlija, që për PDK-në dha 1 mijë euro donacion në vitin 2010, dhe nga institucionet e drejtuara nga PDK-ja ka marrë afro 800 mijë euro, nga Komisioni për Miniera dhe Minerale ka marrë një licencë për eksploitim të zhavorrit në vitin 2002-2005 dhe është edhe huadhënëse e 90 mijë eurove për deputetin e PDK-së, Ramiz Lladrovci.

“Metali”, nga Vitia, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka publikuar emrin e personit kontaktues, nga kjo komunë në vitin 2011 është shpërblyer me tenderin “Furnizimi me inventar për shkolla dhe institucione parashkollore”, që peshon afro 140 mijë euro. Preportr, ka gjetur se një kompani me emrin “Metali”, nga Vitia, e që për pronar ka Elbasan Alidemën, është financuese e PDK-së.

“Arberi NS”, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, bashkë me kompaninë “Jehona”, pronë e Hazir Krasniqit ka marrë hise në tenderin “Asfaltimi i segmentit të rrugës Dabishec-Hajkobilë”, që peshon 265 mijë euro. Të dyja kompanitë janë financuese të PDK-së dhe hisedarë të tenderëve të institucioneve që drejtojnë njerëzit e kësaj partie dhe institucioneve të tjera.

“Zuka Commerc”, pronë e Muhadin Zukës, në vitin 2012 është shpërblyer nga Komuna e LDK-së me tenderin “Asfaltimi i rrugës Busi-Marevc – faza e parë”, që peshon mbi 180 mijë euro. Nga MTPT-ja e kohës së Fatmir Limajt, kjo kompani ka marrë tenderë publik në vlerë mbi 800 mijë euro. Muhadin Zuka është familjar i Florim Zukës, pronar i Kompanisë “Tali” i cili ka aktakuzë për korrupsion nga EULEX-i, si pjesë e “Grupit Limaj”, në hetimet që filluan në vitin 2009.

Kompania “Tali”, për PDK-në, në vitin 2009-2010 dha 11 mijë euro donacione, përderisa në ish-MTPT për këto dy vite ka marrë 8 tenderë publikë, vlera e të cilëve arrin në 7.8 milionë euro.

Edhe “Al - Trade” SH.P.K., pronë e Bajram Gashanit, në vitin 2009 ka marrë nga Komuna e Prishtinës tenderin “Ndërtimi i shkollës së gjelbër në Prishtinë”, që ka vlerë 1.4 milionë euro. Kjo kompani është shumë e pranishme në tenderët publik, pronari i së cilës është me origjinë nga qendër-peshimi i PDK-së, Drenasi. Kjo kompani, vetëm në Ministrinë e Arsim-it ka marrë shtatë tenderë me vlerë prej afro 9 milionë euro. Kjo kompani në konzorcium me kompaninë “Ada Consulting Group”, pronë e zyrtarit të Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK), Avni Kastrati,

## KOMPANITË QË ISHIN PJESË E TENDERËVE TË KURDISUR:

**1** Tenderi i kurdisur për kamionin e zjarrfikësve - 2009: “All Zone”, “Fast NP”, “Ideal Solutions” dhe “Pro Trade”. Këto kompani bashkë deri tash kanë marrë 12.7 milionë euro, si dhe shfrytëzimin për 20 vite të nënkalimit në rrugën “Bill Klinton”, me anë të kompanisë “Pro Trade”.

“Beni Dona Plast” pronë e Rragip Mustafës, që nga viti 2006 është zënë nga ZAP si borxhli i keq i Komunës së Prishtinës, kurse pronari i saj është edhe ndërtues i objekteve kolektive në mënyrë ilegale. Por, ky biznesmen, me këtë kompani dhe me kompaninë “Olti Trasing”, ka marrë tenderë, nga ata që ka nxjerrë Preportr, mbi 3.4 milionë euro.

“ÇLIRIMI “ SH.P.K., pronë e Salih Dakaj nga Prizreni, nga tenderët e vlerës së madhe dhe të mesme që ka shikuar Preportr, del që nga Komuna e Prishtinës, nga viti 2009-2012, ka marrë tenderë në vlerë prej mbi 8.6 milionë euro. Për tenderët që lidheshin me këtë kompani në vitin 2011 ishin arrestuar një sërë zyrtarësh të Komunës së Prishtinës, duke përfshirë këtu edhe ish- shefin e prokurimit, Ekrem Rexha, të cilët mbrohen në liri dhe priten të dalin para gjykatës.

ka marrë një tender prej 600 mijë eurosh nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, projekt ky për të cilin ZAP gjeti shkelje. Në këtë kompani, ka qenë i punësuar edhe Fadil Demaku, deputet i PDK-së, ish zyrtar i SHIK-ut.

Megjithëse zyrtarisht nuk është as financuese e PDK-së, por as e LDK-së, “Alko-Impex”, pronë e Imer Ademit, nga Komuna e Prishtinës, në tenderët që ka shikuar Preportr, del deri më tani të jetë fituese e tenderit “Ndërtimi i rrugës ‘Qemajl Stafa’, që kushton mbi 870 mijë euro. Por, kjo kompani është e kontraktuar edhe për rindërtimin e rrugës “Bill Klinton”, kontratë që e fitoi në vitin 2010, dhe që peshonte mbi 1.6 milionë euro. Në vitin 2008, ZAP kishte gjetur se Komuna e Prishtinës bëri shkelje kur kësaj kompanie i dha tenderin për ndërtimin e rrugës “Slivovë - Viti e Marevcit”. Kjo kompani është kontraktore e rregullt e Ministrisë së Infrastrukturës (MI), ku merr hise, përveç në tenderët e rregullimit të infrastrukturës, po ashtu edhe në tenderët e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve. Sipas gjetjeve të Preportr, në MI, që atëherë quhej Ministria

e Transportit dhe Postë-telekomunikacionit (MTPT), “Alko Impex” ka marrë tenderë në vlerë prej afro 6 milionë euro, vetëm deri në vitin 2011.

### KONTRATA TOP-SEKRET ME “AMM”-NË

Në fushatën parazgjedhore të vitit 2010, për dallim të asaj të vitit 2009, Lidhja Demokratike e Kosovës vendosi të publikojë pak emra të financuesve të saj. Preportr, në raportin e auditimit të financave të partive të publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), ka gjetur se një pjesë e tyre janë biznesmenë.

Preportr, ka gjetur se pjesa më e madhe e tyre nuk kanë marrë hise në tenderët publik, por ka edhe nga ata që janë favorizuar për më shumë se një dekadë, siç është rasti i “AMM”, pronë e Gezim Salihut dhe Ahmed Kurtollit, që për LDK-në dha një donacion prej 950 eurosh.

AMM-ja është një kompani e favorizuar nga Komuna e Prishtinës, pasi që ajo që nga viti 2000 mban monopolin e vendosjes së reklamave në kryeqytet, derisa kontrata mbi të cilën ajo punon mbahet si top-sekret nga Komuna e Prishtinës.

Në vitin 2006, ZAP gjeti plotë parregullsi dhe shkelje ligjore në kontratën me kompaninë AMM. Preportr ka publikuar deri më tash dy hulumtime (“Monopoli komunal në reklama” dhe “AMM – Absolut Mustafa Monopol”) për këtë kontratë, por ka hasur në bllokim total nga ana e Komunës së Prishtinës, kur bëhet fjalë për qasje në dokumente publike, respektivisht kontratën e “AMM”-së.

Preportr, pati gjetur se tenderi i vitit 2006, vit në të cilin u ripërtëri kjo kontratë sekrete, ishte i kurdisur, duke qenë se kompanitë/konzorciumet që garonin për këtë kontratë ishin të lidhura me njëra-tjetrën, duke pasur pronarë të njëjtë. Por, çuditërisht, KRPP-ja nuk kishte konstatuar ndonjë shkelje në këtë tender, pos faktit që Komuna nuk i kishte lajmëruar kompanitë që nuk kishin fituar tenderin, ani pse ato ishin me pronarë të ndërlidhur në mes vete.

### “TAKSIT PRESIDENCIAL” VS “TAKSIT KOMUNAL”

Fatmir Sejdiu, asnjëherë në deklarimin e pasurisë në Agjensionin Anti-korrupsion, nuk i deklaroi bizneset e djalit të tij, Shqipos. Mirëpo, lidhja me familjen Aba-

**2** Reklamata ende i kontrollojnë kompania “AMM”, pronë e Gezim Salihut, Ahmed Kurtollit që për LDK-në dha një donacion prej 950 eurosh. Kontrata e parë e tyre nuk dihet si u dha, në vitin 2000, pasi që Komuna e Prishtinës e ruan si top-sekret. Por, kur kontrata u vazhdua në vitin 2006, tenderi i kurdis, ku krejt kompanitë në garë ishin të ndërlidhur në mes vete, derisa edhe ZAP ka gjetur shkelje në këtë kontratë.

zi, më saktësisht me biznesmenin Meriton Abazi, kishte bërë që në vitin 2009, familjes presidenciale të Sejdiut t’i dilte edhe një biznes që po përfitonte nga asetet publike. Meriton Abazi, ishte ortak në kompaninë “London Taxi”, e cila është në emër të Shqipo Sejdiut, ku aksione kishin edhe Muhamet Berisha, Etrit Zeneli e Luan Berisha.

Ky biznes u pajis me licencë taksie nga Komuna e Prishtinës për të operuar si radio-taxi në kryeqytet, në kohën kur kreu i Komunës, Isa Mustafa, shërbente edhe si këshilltar për ekonomi i presidentit Fatmir Sejdiu.

Por, as Isa Mustafa nuk i qëndroi larg licencës së radio-taxive. Në vitin 2010, Komuna e Prishtinës, dha leje pune për radio-taxin “City Taxi”, pronarë të së cilës ishin Burim Hasani e Gëzim Idrizi. I pari është nga familja Fona, prej nga është edhe Isa Mustafa, dhe nip i Hazbi Hasanit, i cili ishte ortak me djalin e madh të Mustafës, Arbenin në kompaninë, “Intereuropa Kosova L.L.C.”, përderisa i dyti, vozitës i tashëm i kryetarit Mustafa.

### MUSTAFËS I NGJAJNË DJEMTË, I BËHEN BIZNESMENË

Sallonit i veturave “Makcar”, kompani e kryetarit Isa Mustafa, gjendet në magjistralen Prishtinë-Shkup, në kilometrin e tretë. Sipas Arben Mustafës, toka ku zhvillon biznesin kjo kompani është e marrë me qira për tri vjet. Kompania ka filluar të punojë vetëm një muaj e pak ditë pasi është konstituuar, pasi që “Makcar” është themeluar më 14 prill të këtij vitit 2010, kurse sipas bashkëpronarit Besnik Mustafa, punën e ka filluar më 17 maj të po atij viti.

BMW-ja është kompani nga Gjermania, ku Isa Mustafa në vitin 2009 kishte pasur një sërë udhëtimesh zyrtare.

Përveç në kompaninë “Makcar”, që në deklarimin e parë të pasurisë, më 2010, Isa Mustafa pati thënë se ka 49% të aksioneve, kryetari i Prishtinës po atë vit ka deklaruar se i ka edhe tri biznese të tjera. Mustafa është bashkëpronar me 20% të aksioneve në “Universitetin Riinvest”, me 1.6% të aksioneve në Klubin Futbollistik “Prishtina”, si dhe me 5% të aksioneve në “Intereuropa Kosova L.L.C.”. Në këtë kompani ai ishte në ortakëri me Hazbi Hasanin dhe “Intereuropa D.D.”, kurse si person i autorizuar në biznes, pos djalit të tij, Arben Mustafa, ishte edhe An-

drej Kari.

Në deklarimet e mëvonshme, Mustafa specifikonte se pos në “Riinvest”, në kompanitë tjera, aksionet i përfaqësonin të bijtë e tij, Arbeni e Besniku. Ky i fundit në vitin 2010 do të merrte guximin t’i futej edhe sektorit të transportit ku edhe themelon kompaninë “Prime Travel”, derisa fillimin e punës së saj e kishte bërë pa marrë licencën nga ish-MTPT-ja, e drejtuar atë botë nga Fatmir Limaj.

Pasuria e Isa Mustafës, me aksionet dhe profitet e paragyjuara të bizneseve të të bijve, e deklaruar vullnetarisht në AKK, është mbi 700 mijë euro.

### HISJA E ISH-PRESIDENTIT FATMIR SEJDIU

“Toifor”, kompani në pronësi të Enver dhe Isuf Zymerit, në vitin 2011-2012, është gjetur se ka marrë tenderë nga Komuna e Prishtinës në vlerë mbi 670 mijë eurosh. Këta biznesmenë të familjes Zymeri, që në kompaninë e importit të kafes “Empire” janë ortakë biznesi me djalin e ish-presidentit dhe ish-kryetari të LDK-së, Fatmir Sejdiu, janë dhe hisedarë të tenderëve për mirëmbajtje të rrugëve nga Komuna e Prishtinës, që nga viti 2007.

Në “Empire” aksione ka pasur edhe Meriton e Teuta Abazi, të afërm të familjes së Sejdiut. Meriton Abazi ishte aksionar në kompaninë “Media Press” që botonte gazetën “Prishtina Post”.

Tenderi për mirëmbajtjen e rrugëve, duket “Copy-Paste”, pasi që fitohet nga kompani të njëjta, të lidhura në ortakëri me të bijtë e Fatmir Sejdiut. Kështu në vitin 2007, tenderin e njëjtë e fitoi kompania “V.Z. Company” për 7,914 euro dhe kompania “Dardania” për 8,870 euro, në një tender që krejt ishte 11,250 euro.

Në kompaninë e parë ishte aksionar Isuf Zymeri, që tash është po ashtu bashkë-aksionar në “Toifor”. Kjo kompani ka vazhduar të merrte hise nga fondet publike për mirëmbajtjen infrastrukurore të kryeqytetit, ani pse është pjesë e listës së kompanive që në vitin 2009 u patën ndëshkuar nga vetë komuna për shkelje të kontratës. Kjo kompani ka marrë para nga fondet publike edhe në vitin 2011, si dhe në vitin që lamë pas.

### “ÇLIRIMI”, EKREM REXHA DHE “SHIK”-U

Kompania “Çlirimi”, pronë e Salih Dakajt nga Prizreni, nga tenderët e vlerës së madhe dhe të

mesme që ka shikuar Preportr, del se nga Komuna e Prishtinës, nga viti 2009-2012, kjo kompani ka marrë tenderë në vlerë mbi 8.6 milionë euro. Kjo kompani, nga MASHT-i dhe ish-MTPT-ja në vitin 2008 ka marrë tenderë në vlerë afro 3 milionë euro.

Për tenderët që lidheshin me këtë kompani në vitin 2011 ishin arrestuar një numër i zyrtarëve të Komunës së Prishtinës, duke përfshirë këtu edhe shefin e prokurimit, Ekrem Rexha.

Para se hetuesia të merrej me Ekrem Rexhën, ishte ZAP-i që gjeti shkeljen të kolektori atmosferik, që i ishte dhënë kompanisë “Çlirimi” nga Prizreni, pronë e Sali Dakaj dhe gjeti se në projektin “Ndërtimi i kolektorit atmosferik” në shumë prej 3,045,674 eurosh, kompanisë po i paguheshin paratë ende pa i kryer punët.

Tash për tash, është konfirmuar aktakuza për këtë rast, e ngritur nga koordinatorja e prokurorëve kundër korrupsionit në Prokurorinë Speciale, Drita Hajdari, që i ngarkon Ekrem Rexhën, Ridvan Shahinin, Refik Sadikun, Halil Fejzium, Hazir Krasniqin dhe Qazim Bajramin me veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autorizimeve në ekonomi. Zyrtarët në fjalë, në krye me ish-shefin e Prokurimit, Ekrem Rexha pritet së shpejti të përballen me prokuroren Hajdari në gjykatë.

Kur këtë punë e mori në duar Prokuroria Speciale, i pari i Prishtinës, Isa Mustafa, e pati akuzuar Policinë dhe Prokurorinë se po punonin për Shërbimin Informativ të Kosovës (SHIK).

#### TENDER PËR ISH-KOLEGUN E PARTISË

“Hidroterm”, pronë e kryetarit të Suharekës, Blerim Kuçi, nga komuna e Isa Mustafës në vitin 2011, në konzorcium me kompaninë “Unicom”, pronë e Muharrem Elshanit, ka marrë tenderin “Ndërtimi i rrugës “B”-faza e dytë”, i vlefshëm mbi 2.8 milionë euro. Kjo kompani është kontraktore edhe e një sërë institucionesh të qeverisjes qendrore e lokale, por edhe kontraktore e projekteve të financuara nga fondet e BE-së, siç është Pallati i Drejtësisë, ndërtimi i të cilit ka vlerë mbi 28 milionë euro, dhe ku kryetari i Suharekës, Blerim Kuçi ka një hise të tenderit. Kuçi vazhdon të bëjë biznes, edhe për kundër legjislacionit kosovar në fuqi, që ndalon zyrtarët të jenë aktiv në biznese private, e edhe përkundër faktit që është i dënuar, dhe ka mbajtur një muaj burg, për injorim të gjykatës, i thirrur të dëshmojë nga Prokuroria e EULEX-it në rastin e njohur si “Kleçka” kundër deputetit të PDK-së, Fatmir Limaj.

Preportr, ka gjetur se në kohën sa ish-MTPT-në po e drejtonte Fatmir Limaj, Blerim Kuçi pati marrë tenderë në vlerë afro gjysmë

milioni euro. Ai kishte qenë pjesë e LDK-së, që nga paraluftra, ku edhe në luftën e fundit ishte ndër të arrestuarit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Për një kohë ka qenë i angazhuar nga ish-kreu i LDK-së, dhe ish-presidenti, Fatmir Sejdiu që të bëjë reforma brenda kësaj partie, por pasi që kishte pranuar që nuk ia ka dalë mbanë me punën që i ishte ngarkuar, bëri transferim në AAK-në e Ramush Haradinajt, ku është ende pjesë e saj.

#### SHPËRBLEHET KOMPANIA E ORTAKUT TË BLERIM THAÇIT

“Almakos”, pronë e Milaim Cakiqit, ka marrë në Komunën e Prishtinës në vitin 2012 tenderin “Furnizim me kamion dhe me makina për kositje të barit dhe largimin e borës”. Këtë tender e ka marrë bashkë me kompaninë “Profitech”, pronë e Basri Asllanit, që është edhe kontraktor i KEK-ut, në kohën kur me tenderët e kësaj korporate publike po udhëhiqte kushëriri i kryeministrit Hashim Thaçi, Njaziu. Gjithashtu, Basri Asllani ka privatizuar ndërmarrjen shoqërore “Llamkos”, në procesin që më vonë ka dalë të jetë i dështuar.

Cakiqi i “Almakos”, është biznesmen që në kompani të ndryshme është bashkë-aksionar me vëllain e vogël të kryeministrit Thaçi, Blerimin. Cakiqi e Blerim Thaçi janë bashkë-aksionarë në kompaninë ndërtimore “Iliria Building”, kurse Cakiqi me kushërinj e vëllezër ka edhe kompanitë “Liria F.C” Sh.p.k., si dhe kompaninë “Ndërmarrja e re Metamb” Sh.p.k. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm pati konstatuar se ka pasur manipulime në një proces privatizimi të ndërmarrjes “Kosova Elektro”, ku fitues ishte shpallur kompania “Liria FC” pronë e Fazli Cakiqit, i afërm i Milaim Cakiqit, më 19 nëntor 2008.

Cakiqi kishte qenë aksionar edhe në kompaninë “Boxon”, që më vonë ndërroi emrin në “OVE Group”. Kjo kompani është kompania që u ankua kundër KEK-ut për tenderin e datës 14.03.2012 për “Shitja e Thëngjillit” që i ishte dhënë konzorciumit “NTN Gërguri – Zyskentrans”. Ishte ankesa e “OVE Group”, në OSHP që anuloi këtë tender. Tenderi është rishpallë, por më 2 korrik 2012 është anuluar përsëri, tash nga vetë KEK-u, me arsyetimin se mungojnë kompanitë e përgjegjshme. Kjo kompani është e lidhur me bizneset e familjes së kryeministrit Hashim Thaçi, jo vetëm nëpërmjet ortakut të Blerim Thaçit, Milaim Cakiqit, por edhe me babain e Visar Banjicës, Hajatin. Ky i fundit është bartës licence për “Geo-Mineral” që operon në Astrazup të Malishevës, derisa për këtë kompani në disa furnizime me naftë në “Kosova Petrol”, të Bedri Selmanajt, figuron emri i vëllait të kryeministrit Thaçi, Idriz Thaçi, ka raportuar Gazeta JNK.

## MILIONAT PËR KOMPANITË E PDK-SË

**Preportr, ka hulumtuar mbi 280 tenderë të mëdhenj dhe të mesëm që nga viti 2007-2012, dhe të cilët kapin një vlerë prej afro 100 milionë eurosh. Nga ta janë gjetur se financuesit e PDK-së nga kjo vlerë kanë marrë mbi 8 milionë euro, kurse kompani të cilat në një formë apo tjetër lidhen me PDK-në, kanë marrë mbi 5.7 milionë euro.**

#### Financuesit e PDK-së:

“**BAGERI**”, pronë e Bujar Shabanit nga Ferizaj, në Komunën e Prishtinës në vitin 2012 është shpërblyer me tenderin “Asfaltimi i rrugëve në Shkabaj dhe Rimanishtë”, që peshon 124 mijë euro.

“**BEJTA COMMERCE**”, pronë e Basri dhe Adem Kçiku nga Gjilani, në vitin 2012 është shpërblyer nga Komuna e Prishtinës që udhëhiqet nga kryetari i LDK-së, Isa Mustafa me tre tenderë që peshojnë bashkë mbi 880 mijë euro.

“**BENI - COM “SH.P.K.**”, pronë e Ismet Konushevcit, në vitet 2010-2012 në Komunën e Prishtinës të udhëhequr tradicionalisht nga LDK-ja ka marrë tenderë, dhe hise nëpër tenderë si pjesë e konzorciumeve të cilët kapin vlerën mbi 3 milionë euro.

“**Kastrioti**”, pronë e Kastriot Fazlija nga Shtimja, në Komunën e Prishtinës në vitet 2011-2012 ka marrë hise nga katër tenderw, duke qenë pjesë e konzorciumeve, vlera e të cilëve peshon mbi 3.6 milionë euro.

“**Metali**”, nga Vitia, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka publikuar emrin e personit kontaktues, nga kjo komunë në vitin 2011 është shpërblyer me tenderin “Furnizimi me inventar për shkollë dhe Institucione parashkollore”, që peshon afro 140 mijë euro.

“**Arberi NS**”, të cilës Komuna e Prishtinës nuk ia ka bërë publik personin kontaktues, bashkë me kompaninë “Jehona”, pronë e Hazir Krasniqit ka marrë hise në tenderin “Asfaltimi i segmentit të rrugës Dabishec-Hajkobillë”, që peshon 265 mijë euro.

#### Kompanitë të ndërlidhura me PDK-në:

“**Zuka Commerc**”, pronë e Muhadin Zuka në vitin 2012 është shpërblyer nga Komuna e Prishtinës, me tenderin “Asfaltimi i rrugës Busi - Marevc - faza e parë”, që peshon mbi 180 mijë euro.

“**AL - TRADE “SH.P.K.**”, pronë e Bajram Gashanit, në vitin 2009 ka marrë nga Komuna e Prishtinës tenderin “Ndërtimi i shkollës së gjelbër në Prishtinë”, që peshon 1.4 milionë euro.

“**ALKO - IMPEX - GENERAL CONSTRUCTION -SH.P.K.**”, pronë e Imer Ademit, nga Komuna e Prishtinës, në tenderët që ka shikuar Preportr, del deri më tani të jetë fituese e tenderit “Ndërtimi i rrugës “Qemajl Stafa”, që peshon mbi 870 mijë euro. Por, kjo kompani është edhe e kontraktuar për rindërtimin e rrugës “Bill Clinton”, kontratë që e fitoi në vitin 2010, dhe që peshonte mbi 1.6 milionë euro.

**N.T.P. “ALMAKOS**”, pronë e Milaim Cakiqit ka marrë në Komunën e Prishtinës, në vitin 2012 tenderin “Furnizim me kamion dhe me makina për kositje të barit dhe largimin e borës”, që peshon afro 130 mijë euro.

**Preportr ka bërë ankesë në institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me moslejimin e qasjes në dokumente zyrtare nga Komuna e Prishtinës. Ky institucion ka pranuar ankesën në fjalë dhe ka shprehur gatishmëri që të zhvillojë hetime për këtë çështje.**

# QYTETI PA ZOT

BESNIK BOLETINI, BESA KALAJA



**KUR MBAROI LUFTA, NË  
KRYEQYTETIN E KOSOVËS,  
U ÇLIRUA BISHA E  
NDËRTIMEVE TË EGRA,  
QË E SHNDËRRUAN ATË  
NË NJË QYTET ME ARKI-  
TEKTURË TURBO-FOLK.  
KUSH E FITOI LUFTËN NË  
KRYEQYTETIN KOSOVAR?**

**N**dërtimi i objekteve të banimit kolektiv është biznesi legal më fitimprurës i pasluftës në Kosovë. Veç që u derdhën miliona euro e u mbuluan qindra hektarë tokë me ndërtime, ky biznes ka shkaktuar kaos urbanistik në kryeqytet, i cili edhe më tutje vështirë po kontrollohet. Ata që e kanë përcjellë nga afër fushën e ndërtimeve në Kosovë, thonë se me këtë biznes është bërë shpëlarje e madhe parash. Këta ndërtues e kanë shfrytëzuar kohën e pasluftës për të filluar ndërtime që kapin vlera milionëshe, pa e ditur prej nga e kanë prejardhjen paratë që kanë hyrë në ndërtim. Megjithëse komuna, është tërësisht e mbyllur për publikun, ajo që nuk mund të fshihet është fakti se ndërtimet në kryeqytetin kosovar thjesht janë bërë të pazrëzueshme për pushtetin, edhe pse ato e kanë shndërruar Prishtinën në një qytet me turbo-folk arkitekturë.

Një zë i rrallë kundër degradimit urban të qytetit u vra. Ekzekutimi i arkitektit, Rexhep Luci, në shtator të vitit 2000 ka ngjallur një rast i pazgjidhur për organet e rendit. Ka gjashtë vite që një organizatë joqeveritare, Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës (IQMQP), po ngre zërin kundër degradimit të qytetit. Lagjet që, sipas kësaj organi-

zate, më së shumti janë degraduar janë “Dodona” dhe lagja “Tophane”. Ngjashëm kanë pësuar edhe lagjet “Qyteza Pejton”, “Mati” e Veterniku.

Ish-zyrtarë të Komunës e pranojnë që ndërtuesit ishin më të fortë se Komuna, prandaj ka qenë e pamundur të kontrollohen ndërtimet e egra, të cilat janë ndërtuar jashtë planit urbanistik. Komuna e Prishtinës, por as qeveria nuk kanë arritur që t’i dalin në rrugë këtij krimi urbanistik e financiar. Sot, Prishtina ka rreth 6100 ndërtime të egra të evidentuara në një proces për legalizim, përfshirë këtu ndërtime të larta, mbindërtime dhe shtëpi banimi në të gjitha lagjet. Një incizim satelitor i bërë në vitin 2010 nga Komuna e Prishtinës, nuk i ndali ndërtimet pa leje. Prej asaj dite, jozyrtarisht është thënë se në Prishtinë janë ndërtuar rreth 400 objekte pa leje.

Mirëpo, këto nuk janë të vetmet ndërtime pa leje. Supozohet që që nga pas lufta, në tërë kryeqytetin të jenë ndërtuar diku 20 mijë objekte pa leje, pa përfshirë këtu mbindërtimet dhe shndërrimin e kateve përdhese të banesave në lokale afariste. Të gjitha objektet e banimit të lartë në qendër të Prishtinës, përdhese i kanë shndërruar në këso lloj lokalesh gjë që, sipas arkitektëve, ka prekur në statikën e objektit, duke rrezikuar

shembjen e tyre në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore.

## LEGALIZIM KOLEKTIV I LEGALES

Prej asaj që Preportr, ka parë në terren, shihet se jo të gjitha ndërtimet e larta që po bëhen në kryeqytet i plotësojnë kushtet urbanistike. Disa prej tyre nuk kanë as parkingje, hapësira të gjelbëruara dhe kushte të tjera që duhet t’i plotësojnë, kritere këto të përcaktuara edhe në manualin e Komunës së Prishtinës.

Komuna e Prishtinës thjesht ka soditur dhe përfituar nga ky biznes. Ejup Bajrami, nga Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës (IQMQP), ka disa vite që po e alarmon jo vetëm komunën, por edhe nivelin qendror të qeverisjes, por deri tani është thjesht i injoruar. Që prej disa kohësh “luftën” e tij më ndërtuesit ilegalë po e bën i vetëm, edhe pse iniciativën e kishte filluar me një grup qytetarësh.

Bajrami, e ka shumë të vështirë punën e tij, sepse përveçse politika ka interesa me ndërtimtarët, me këtë biznes merren edhe vetë politikanët e familjarë të politikanëve, madje edhe të vetë kryeministrit, Hashim Thaçi. Bajrami, ka filluar këtë punë duke i identifikuar objektet pa leje në lagjen ku jeton. Ai thotë se lagja “Kodra

## APLIKIMI PËR LEGALIZIM TË OBJEKTEVE KOLEKTIVE (FAMILJA NOVOSELLA):

- Qazim Novosella, Dodonë
- Adnan Novosella, Dodonë
- Alban Novosella, Dodonë,
- Samire Novosella, Dodonë,
- Dardan Novosella, Vellusha
- Fitim Novosella, Vellusha

## APLIKIMI PËR LEGALIZIM TË OBJEKTEVE KOLEKTIVE FAMILJA PRISHTINA (NOVOSELLA):

- N.T.N Tregtia, Arbëria III
- N.T.N Tregtia, Arbëria III
- Bedri Prishtina, Dodonë
- Mergim Prishtina, Lagjja e Muhaxherëve
- Bedri Prishtina, lagjja Vellusha
- Bedri Prishtina, Dodonë,
- Bedri Prishtina, Tophane
- N.T.N Tregtia, Kodra e Diellit

e Diellit”, ka qenë e urbanizuar para luftës. Kjo lagje ka qenë e planifikuar vetëm për ndërtime të ulëta, por pas luftës shumë objekte kolektive u ndërtuan aty, duke ua zënë hapësirat shtëpive për rreth.

Për të treguar për degradimin e shumë lagjeve, Ejup Bajrami tregon disa raste kur ankesat e tyre janë shqyrtuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe kjo e fundit ka konstatuar në disa raste se nuk është respektuar leja e ndërtimit.

Pas ankesës së IQMQP-së, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, inspektorët e kësaj ministrie e kanë bërë inspektimin e ndërtimit të një objekti në lagjen “Kodra e Diellit” nga investuesit, vëllezërit Loxha, dhe ka vërejtur se investitorët në fjalë e kanë tejkaluar lejen e ndërtimit. Inspektorët e MMPH, i kanë rekomanduar inspektoratit të Komunës së Prishtinës, që të inspektojë objektin dhe të marrë masat adekuate ligjore, pasi që investuesi nuk ka leje përkatëse për të bërë këtë aneks-ndërtim. Por, sipas Ejup Bajramit, MMPH ka urdhëruar pezullimin e këtij ndërtimi, por asnjë masë nuk është ndërmarrë.

Pas rekomandimit nga MMPH për Inspektoratin e Komunës së Prishtinës, ky i fundit i ka kthyer përgjigje MMPH për objektin në fjalë, duke i ofruar edhe dokumentet përkatëse. Pas shqyrtimit të kësaj përgjigje për veprimet e ndërmarrura nga inspektorati i Prishtinës, MMPH ka konstatuar se ky inspektorat ka bërë shkëlqje të Ligjit të Ndërtimit në këtë rast, pasi që nuk ka marrë masa për ndërprerjen e këtyre punimeve.

Në rrugën “Hilmi Rakovica”, objekt kolektiv pa leje, ka ndërtuar familja e deputetit të PDK-së Shaip

Muja. Në këtë objekt një kohë me qira ka banuar kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi. Vëllezërit e kryeministrit, janë po ashtu të përfshirë në ndërtime të larta, nëpërmjet kompanisë “Iliria Building”.

Për objektin ku banonte kryeministri, që po ndërtohej pa leje, Bajrami disa herë e kishte lajmëruar Komunën por pa sukses. Komuna e Prishtinës, i ka kthyer përgjigje, se investitori nuk ka leje ndërtimi dhe se është urdhëruar që të ndërpresë punimet. Por iniciuesi i kësaj ankese, Ejup Bajrami, thotë se punimet kanë vazhduar dhe inspektorati komunal nuk i ka penguar fare.

“Kemi kërkesa të ndryshme kur komuna na i kthen përgjigjet që janë nxjerrë vendimet për rrënim, por rrënimi nuk është bërë kurrë e as që janë ndërprerë punimet. Gjithashtu, kemi raste kur edhe Ministria e Ambientit i ka rekomanduar komunës që të bëjë rrënimin e disa ndërtimeve, por kjo nuk është bërë”, thotë Bajrami.

Në mesin e atyre që kanë ndërtuar pa leje dhe që kanë kontribuar në shëmtinë e qytetit ka edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, këshilltarë dhe zyrtarë komunal, por edhe njëra ndër kompanitë më të mëdha të ndërtimit në kryeqytet, kompania “Tregtia”.

Këshilltarë dhe zyrtarë të Kuvendit Komunal të Prishtinës, kanë përfituar nga ndërtimet e egra në Prishtinë. Për legalizimin e shtëpisë ka aplikuar ish-drejtoresha e Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, Nazane Breca, tash deputete në Kuvendin e Kosovës nga radhët e LDK-së, Ahmet Frangu, shef i sektorit të tregut, Refik Sadiku, shef i sektorit në Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale, Fadil Leci, shef i sektorit për mirëqenie sociale, Azem Imeraj, bashkëpunëtor për

punë gjeodeote në Drejtorinë e Urbanizimit, Shiqeri Jupolli, inspektor i të ardhurave buxhetore në Drejtorinë e Financave dhe Pronës, Nefi Krasniqi, shef i zyrës së pritjes. Kërkesë që ta legalizojnë shtëpinë kanë bërë edhe këshilltarët komunalë, Hazir Burovci e Shaip Hajrizi. Degradimit të kryeqytetit i kanë kontribuar, veç Nazane Breccës, edhe dy deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Berat Buzhala e Justina Shiroka-Pula.

Shtëpinë pa leje e ka ndërtuar edhe ish-drejtori i Urbanizimit në Komunën e Prishtinës, Shiqeri Spahiu. Ai, në një konferencë për medie e pati pranuar se e ka ndërtuar shtëpinë pa leje, ndërsa kryetari i Komunës, Isa Mustafa, pati thënë se shtëpia e tij do të hyjë në proces të legalizimit, e nëse nuk i plotëson kushtet do të rrënohet. Spahiu, nuk ka aplikuar për legalizim ndërsa nuk dihet a ka marrë leje në ndërkohë për shtëpinë e tij.

Nga rreth 6 mijë e 100 objektet pa leje që pronarët e tyre kanë aplikuar për legalizim, Preportr, ka gjetur se në mesin e tyre janë rreth 100 objekte kolektive që i kanë hyrë këtij procesi.

Familja Novosella, ka në pronësi disa biznese ndërtimore. Që nga paslufta, kjo familje, ka bërë shumë ndërtime kolektive, shumë prej tyre pa leje paraprake, por që më vonë ka bërë kërkesë për legalizimin e tyre, duke aplikuar si individë e jo si kompani. Novosellët, kanë bërë gjithsej gjashtë kërkesa për legalizim të objekteve kolektive, objekte këto që i kanë ndërtuar përmes kompanive të tyre që i kanë në pronësi.

Në kompaninë ndërtuese “Dardania Company” pronarë janë: Ilir Novosella, Alban Novosella dhe Dardan Novosella. Ky i fundit është edhe pronar i kompanisë tjetër “Dardania Com”.

Edhe kompania “Tregtia”, ka aplikuar disa herë për legalizimin e objekteve kolektive, që do të thotë se këto ndërtime kolektive kanë qenë pa leje. Për legalizimin e këtyre ndërtimeve, “Tregtia” si kompani ka aplikuar tri herë, kurse Bedri Prishtina dhe Mërgim Prishtina si individë kanë aplikuar pesë herë.

Bedri Prishtina, që e ka nip pronarin e “Dardania Company”, Dardan (Sabri) Novosellën, është pronar i kompanisë ndërtuese “Tregtia”, e cila ka në pronësi edhe kompaninë tjetër “Dardania” sh.p.k., ndërsa person fizik në këtë kompani është Mërgim Prishtina.

Kompania “Tregtia”, nuk është ndëshkuar nga Komuna e Prishtinës për degradimin që i ka bërë qytetit me ndërtimet pa leje. Përkundrazi, ajo po merr leje dhe po ndërton në lagje të ndryshme të kryeqytetit. “Tregtia”, është shumë e pranishme në tregun e shit-blerjeve të banesave në kryeqytet. Edhe djali i të parit të Prishtinës, Besnik Mustafa ka blerë banesë nga kjo kompani.

Ajo që shihet viteve të fundit, është fakti që shumë kompani që kanë ndërtuar pa leje si kompania “Dardania Company”, pronë e familjes Novosel-

Sot, Prishtina ka rreth 6100 ndërtime të egra, përfshirë këtu ndërtime të larta, mbindërtime dhe shtëpi banimi në të gjitha lagjet. Një incizim satelitor i bërë në vitin 2010 nga Komuna e Prishtinës, nuk i ndali ndërtimet pa leje. Prej asaj dite jozyrtarisht është thënë se në Prishtinë janë ndërtuar rreth 400 objekte pa leje.

la, nuk janë edhe aq aktive sa kanë qenë më herët.

Ndërtimet e mëhershme të kësaj kompanie i kanë shpëtuar rrënimin edhe pse të përcjellura nga kamerat e televizioneve.

### QINDRA E MIJËRA MBINDËRTIME E NDËRTIME ILEGALE

Krejt të zezat që janë përfolur e shkruar për kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën, i kanë vërtetuar dy inspektorë nga Drejtoria Komonale e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Inspektorët, Fehmi Ahmeti e Shaban Huruglica, kanë inspektuar pothuajse çdo ndërtesë në kryeqytet që ka më shumë se katër kate. Nga inspektimi që ka zgjatuar për më shumë se dy vjet, ata kanë konstatuar mijëra mbindërtime, qindra ndërtime ilegale, e po aq uzurpime të pronës publike.

Këta inspektorë, vizitën e tyre e kanë realizuar në të gjashtë bashkësitë lokale të Prishtinës, nga kanë konstatuar se, sa i përket sigurisë së jetës dhe pasurisë së qytetarëve, “githçka është skandalozë”.

“Në asnjë objekt të inspektuar nuk ka hidrant e as aparat zjarrfikës, nuk ka drita e shkallë emergjente (përveç në 3-4 banesa), e as podrume të pastra”, shkruajnë këta inspektorë në një raport të brendshëm mbi uzurpimet, raport ky prej 11 faqesh.

Më 27 prill të vitit 2010, nëpërmjet drejtorit Agim Gashi, nga këta dy inspektorë i është dërguar ish-drejtorit të Inspeksionit, Qazim Çunaku, një kërkesë për iniciimin e procedurës ligjore ndaj shpërdoruesve të pronës shoqërore-publike nëpërmjet banesat shumëkatëshe në territorin e Prishtinës.

Pas konstatimit, që jeta dh pasuria e qytetarëve banojnë në Prishtinë është në rrezik, dy inspektorët ia kanë dhënë një “këshillë” Inspeksionit Komunal: “Konsiderojmë dhe vlerësojmë se Drejtoria për Inspeksion, si organ i vetëm komunal e përgjegjës për çështje mbi uzurpimet e sipërfaqeve publike, duhet urgjentisht të marrë masa për largimin e keqpërdoruesve, mënjanimin e ndërtimeve pa leje dhe lirimimin e sipërfaqeve të përbashkëta nëpërmjet banesa. Me qëllim të eliminimit të rreziqeve që kanosin jetën e pasurisë e qytetarëve, luteni që urgjentisht të eliminohen pengesat që do të cekim”, thuhet në raportin në fjalë.

Në faqet e para të këtij raporti, inspektorët kanë gjetur se në të gjitha ndërtesat, me përjashtime shumë të vogla, ka së paku nga një mbindërtim, por ka edhe raste kur gjysma e ndërtesës është e mbindërtuar.

Kjo vlen sidomos për Bashkësinë e Parë, që është në qendër të Prishtinës. Aty, sipas raportit, ka ndërtesë 5-katëshe, që nga dy kate i kanë mbindërtim. “Karakteristikë e përbashkët e këtyre gjashtë bashkësive lokale, që janë ndër bashkësitë më të mëdha të kryeqytetit, edhe me numër të banorëve, janë keqpërdorimet më të mëdha, me mbindërtime, me ndërtim të destinimit të hapësirës, uzurpime e të tjera gjëra”, shkruan në raport.

► VAZHDON NGA FAQJA 7

## TOP-LISTAE 22 KEQPËRDORIME- VEMË SKANDALOZE

Pos që nuk e kanë kursyer mundin, që për dy vite me radhë të evidentojnë pjesën më të madhe të keqpërdorimeve të territorit të Komunës së Prishtinës, inspektorët kanë gjykuar ashpër atë që ka ndodhur. Cilësimi më i shpeshtë i tyre për keqpërdoruesit është “matrapaz”. Raporti ndër të tjera thotë: “Garazhet në ‘Qafa’, në sipërfaqe prej 10.000 metra katrorë, mbi 250 garazhe janë nën menaxhimin e një matrapazi”; “Garazhet banesore, veçmas ajo në rrugën UÇK, janë lënë nën mëshirën e matrapazëve të ndryshëm”; “Familja e Sokol Ramadani nga Skënderaj shfrytëzojnë serverin e ‘Obodinit’. Nga këta matrapazë shtetit i janë bërë shpenzime për ujë në shumë prej 18 mijë euro”. Këto janë vetëm disa nga cilësimet e inspektorëve.

Inspektorët kanë përzgjedhur një “top-listë” të keqpërdorimeve dhe të ndërtimeve ilegale. Në këtë listë janë futur 22 keqpërdorimet “me skandaloze”. Të përzgjedhurit e inspektorëve kanë të bëjnë që nga ndërriimi i destinimit të pronës, bllokimet e hyrjeve, përdorimi i aseteve të për-bashkëta, siç është uji për autolarje, hapja e bizneseve që shërbejnë ushqim vend e pa vend, e deri te bllokimi i kutive të rrymës. Nuk mungojnë as rastet kur bodrumet e përbashkëta i ka “fshi” veç një individ, që inspektorët i cilësojnë si matrapaz. Kurse, të mbindërtimet, janë përzgjedhur 12 rastet “me skandaloze”. Kjo listë fillon një mbindërtim në rrugën “Sadik Zeneli”, ku vërehen dy mbindërtime dhe përfundon me një mbindërtim në Plato. “Përballë Kurrizit dhe Platosë, ndërtesa dykatëshe ka dy mbindërtime”, përfundon ky raport 11-faqesh.

## LEGALIZIME PA LIGJ

Komuna e Prishtinës, është kritikuar shumë se e ka filluar procesin e legalizimit pa bazën e nevojshme ligjore. Qeveria e ka miratuar Projektligjin për legalizimin e objekteve pa leje tek në fund të vitit 2012. Ky ligj nuk dihet kur do të hyjë në fuqi.

Organizata, Iniciativa për Progres, që e monitoron punën e Komunës së Prishtinës, në një raport të saj për marrje të lejeve të ndërtimit në Komunë, ka vërejtur se komuna nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe teknike për të bërë detajisht inspektimin e gjithë objekteve që kanë aplikuar për legalizim.

“Pasi që ka një numër shumë të madh që kanë aplikuar për legalizim, më se 6148 kërkesa, në proces të legalizimit janë rreth 500 prej tyre, të cilat janë të parapara t’i plotësojnë kushtet minimale, ndërsa janë legal-

izuar diku rreth 100 prej tyre. Në kuadër të këtyre lëndëve, 2,600 prej tyre janë lëndë të trajtuar në plotësim të dokumentacioneve të nevojshme, të cilat janë të parapara me ligj”, thuhet në raportin e INPO.

## SIN’BAHÇET’BABËS

Prishtina nuk ka një plan urbanistik si kryeqytet, por në vend të kësaj përdorë të ashtuquajturat plane rregulluese, të cilat thjeshtë mbulojnë lagje të caktuara të qytetit. Disa nga kompanitë ndërtuese kanë bërë ndërtime jashtë planit rregullativ. Sipas Ejup Bajramit nga IQMQP, një nga arsytet pse ata kanë bërë këto ndërtime ishte ndërtimi në terren të gatshëm.

“Ndërtuesit që kanë ndërtuar nëpër lagjet e Prishtinës, pa leje të nderimit, e jashtë planit rregullativ nuk kanë paguar as për ujësjellës, as për rrymë, as për asfaltim e as kanalizim, sepse në këto lagje i kanë pasur të rregulluara të gjitha. Në 5 ari të ndërtohet një banim kolektiv është degradim, por jo vetëm i atyre që banojnë në atë ndërtesë, por i gjithë tjerëve, sepse ai oborr është pa trotuar, pa parking, pa gjelbërim pa hapësirë për lojëra për fëmijë”, thotë Bajrami.

Ai thotë se, IQMQP në vazhdimësi iu ka shkruar të gjitha institucioneve kompetente për këtë degradim, por asnjë nga ato nuk ka marrë masa, ndërsa hedh dyshimin se në këto ndërtime janë të kyçur edhe vetë drejtuesit e këtyre institucioneve.

Nebih Zariqi, kryetar i Shoqatës së Ndërtimtarëve të Kosovës, thotë se Komuna e Prishtinës jep leje për ndërtim, duke kufizuar hapësirën gjelbëruese, parkingjet etj. Ai thotë se planet urbanistike nuk po zbatohen si duhet dhe se ka raste kur nuk ka mbikëqyrje dhe leja u jepet projekteve që degradojnë qytetin.

Zariqi, ka bërë ndërtime të larta në kryeqytet edhe në kohën kur ka qenë nënkryetar i Komunës së Prishtinës. Ai thotë se degradimet më të mëdha dhe të pariparueshme janë ato të lagjeve “Tophane” dhe “Dodona”. Sipas tij, edhe lagja “Mati” po zhvillohet shpejt dhe disa vende është degraduar, por ka ende mundësi që kjo të evitohet.

“Kemi pasur lagje që kanë qenë gati të përgatitura për ndërtim si “Arberia 2”, sepse ka qenë një projekt i bërë më herët. Mirëpo nuk ishin të interesuar”, u shpreh Zariqi.

Komuna e Prishtinës, është kritikuar shumë edhe për procedurën të stërzgjatë për dhënie të lejeve të ndërtimit. Lidhur me lejet pati dhënë dorëheqje vitin e kaluar drejtoresha e Urbanizmit, Luljeta Sokoli, përderisa komuna e mbush gjysmën e buxhetit tek të hyrat vetjake nga dhënia e lejeve për ndërtim.

## KRYEPOZITARI JO TRANSPARENT

Edhe pse Komuna e Prishtinës udhëhiqet nga opozitari Isa Mustafa, ajo është e mbyllur dhe indiferente ndaj kërkesave për informacion. Nuk lejon qasjen në dokumente relevante publike, që mund të shërbejnë si bazë për të hulumtuar mënyrën e udhëheqjes së kryeqytetit. Hulumtimi i Preportr, mbi Komunën e Prishtinës, ka qenë më i vështiri i kësaj natyre deri sot. Komuna nuk ka ofruar asnjë bashkëpunim.

Në mbi dhjetë kërkesa për qasje në dokumente zyrtare në Komunën e Prishtinës, Preportr në shumicën prej tyre nuk ka marrë përgjigje fare ose ka marrë përgjigje tjera nga ato të kërkuara. Një pjesë e përgjigjeve ka pas informacione gjysmake, e herë-herë edhe përgjigje krejt jashtë kontekstit që është parashtruar pyetja.

### Deputetët që kanë aplikuar për legalizim të shtëpive:

Nazane Breca, ish-drejtoreshë e Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, tash deputete në Kuvendin e Kosovës nga radhët e LDK-së, Berat Buzhala dhe Justina Shiroka-Pula nga radhët e PDK-së.

### Zyrtarë të KK Prishtinës që kanë aplikuar për legalizim:

Ahmet Frangu, shef i sektorit të tregut, Refik Sadiku, shef i sektorit në Drejtorinë e Infrastruktura Lokale, Fadil Leci, shef i sektorit për mirëqenie sociale, Azem Imeraj, bashkëpunëtor për punë gjeodete në Drejtorinë e Urbanizmit, Shiqeri Jupolli, inspektor i të ardhurave buxhetore në Drejtorinë e Financave dhe Pronës, Nefi Krasniqi, shef i zyrës së pritjes.

### Këshilltarët komunalë:

Hazir Burovci dhe Shaip Hajrizi.

## LULI N’BANESË T’GJENERALIT!

Dallaveret me pasuri të patundshme në zonën e Prishtinës janë të moçme. Edhe pse dëshmitari bashkëpunues i EULEX-it, Nazim Bllaca deklaroi se Shërbimi Informativ i Kosovës (SHIK), agjent i së cilit shpallë vetën, ka qenë i përzier në tjetërsim të kundërligjshëm pronash, Kadri Veseli që drejtoi këtë agjenci deri në shkurt të vitit 2008, thotë se ata e luftonin këtë fenomen. Bllaca pat akuzuar edhe ish-shëf-in e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, Ahmet Shalën, se sa ka qenë në krye të kësaj agjencie ka falur patundshmëri për zyrtarë të ndryshëm e politikanë. Shala tani është larguar nga Kosova duke u emëruar ambasador në Japoni.

Preportr, në qershor të vitit 2012 ka publikuar hulumtimin “Armatura e SHIK-ut”, në të cilin janë publikuar edhe dokumente të transaksioneve që lidheshin me shitblerje tokash në mes Ballcës e Fahredin Gashit-Farukut, ky i fundit tashmë i dënua për krime lufte.

Kadri Veseli problemin e pasurive të patundshme në Prishtinë e shpjegon edhe me anë të banesës së tij.

Ai thotë se menjëherë pas luftës ka blerë një banesë në Ulpianë, nga pronar legal shqiptar. Pas krijimit të familjes së vet, përkatësisht nga viti 2003, ka në pronësi së paku një banesë në qendër të kryeqytetit, të cilën po ashtu thotë se e ka blerë nga një shqiptar, të cilit nuk do t’ia zbulojë emrin. Duke qenë se bllok i banesave ku tani jeton Kadri Veseli u përkiste gjeneralëve serb, ish-shëf-i SHIK-ut nuk e mohon mundësinë që banesa të ketë qenë me herët edhe në pronësi të ndonjë gjenerali serb.

Kadri Veseli, që thotë se vetë është kujdesur që të mos blejë në kryeqytet një pronë me konteste, por si shef i SHIK-ut, ka një rrëfim edhe për procesin e transaksionit të pronave në Kosovë, e në regjionin e Prishtinës në veçanti.

Ai thotë se duke ndjekur elementë të shërbimeve inteligjente serbe, kanë rënë në gjurmë të tjetërsimeve të kundërligjshme të pronave, në veçanti në rajonin e Prishtinës, pas të cilave qëndronin këta elementë.

“Kam arsye të besoj se një pjesë e madhe e tjetërsimit të pronave në mënyrë të kundërligjshme janë bërë me ndihmën dhe implikimin e shërbimeve inteligjente serbe dhe elementeve të tyre. Ata, nuk përjashtohet se i kanë ndihmuar mashtruesit dhe sekserët e ndryshëm në Kosovë nëpërmjet dokumenteve juridike të lëshuara në Serbi para dhe pas luftës në Kosovë. Vlera e këtyre transaksioneve ka qenë marramendëse, këto mjete mund të jenë përdorë edhe për financimin e strukturave paralele serbe në Kosovë”, thotë Veseli. Sido që të jetë, deri sot nuk dihet ndonjë denoncim i bërë nga SHIK-u, për këto vepra që dyshon shefi i kësaj strukture, që ka funksionuar si një krah para-legal i partisë në pushtet, PDK-së. Sot, Veseli është zëvendës i kryeministrit në parti.

Në interesimin tonë se në këto transaksione të dyshimta, a mund të ketë pasur edhe njerëz të luftës, Veseli thotë “Ka pasur fatkeqësisht!”.

Veseli edhe pse pranon që kanë pasur informacione për tjetërsime pronash në vlera milionëshe, nuk tregon se çka ka bërë me këto informacione. Thotë se ka pasur raste kur kanë ndërhyrë tërthorazi dhe kanë pasur sukses në pengimin e tjetërsimit të pronës shoqërore, nga niveli i kompetencave dhe përgjegjësi në rrethana të kohës, por nuk pranon që të flasë për raste konkrete.

“Ky botim është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”



“Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”. Përmblajtja e këtij botimi është përgjegjësi e ÇOHU dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.